



"Televizioni Alsat-Kosova" SH.P.K.
Pronar: Ferik VELIJA
OSHP TV ALSAT KOSOVA
OSHP06
Rr/Hamz Jashari p.n.
Prishtinë

Ref: 1404/530/KPM/ni

VENDIM

për shpalljen e pavlefshme të licencës të OSHP TV ALSAT KOSOVA

Faktet

1. Komisioni i Pavarur për Media (KPM), në bazë të nenit 3, paragrafi 2.6. të ligjit për KPM (Ligji nr. 04/L-44), nxjerr akte nënligjore për rregullimin e transmetimit dhe të shërbimeve mediale audio-vizuele, të cilat nevojiten për të kryer funksionet e saj në pajtim me standardet ndërkombëtare.
2. OSHP TV ALSAT KOSOVA është një ofruer i shërbimeve programore i licencuar nga Komisioni i Pavarur për Media (KPM), për të ofruar programe përmes rrjetit kabllor, në pajtim me rregulloren CIMC 2007/04. OSHP TV ALSAT KOSOVA është pajisur me licencë të KPM-së më 05 dhjetor 2008.
3. OSHP TV ALSAT KOSOVA edhe pse është licencuar nga KPM, për të vepruar si Ofruer i Shërbimeve Programore me seli në Prishtinë, asnjëherë nuk ka filluar me transmetimin e programit.
4. Më 16 dhjetor 2013, KPM është njoftuar zyrtarisht me shkrim nga OSHP TV ALSAT KOSOVA, se heq dorë nga licenca për ofrimin e shërbimeve programore.
5. Përmes të njëjtës shkresë, OSHP TV ALSAT KOSOVA, ka njoftuar se për shkaqe financiare heqë dorë nga licenca e KPM-së.

Arsyetimi


6. Me njoftimin e OSHP TV ALSAT KOSOVA që në mënyrë vullnetare heqë dorë nga licenca e ofruesit të shërbimeve programore, Komisioni, merr Vendim për shpallje të pavlefshme të licencës të OSHP TV ALSAT KOSOVA.

Vendim

7. Komisioni merr këtë Vendim përmes të cilit shpallë të pavlefshme Licencën e OSHP TV ALSAT KOSOVA për ofrimin e shërbimeve programore, që nga data e njoftimit të përfaqësuesit të OSHP TV ALSAT KOSOVA.

Lëshimi i Vendimit

8. Këtë Vendim e lëshon Komisioni dhe i njëjti është i vlefshëm që nga data e nënshkrimit të tij.



Adnan MEROVCI
Kryetar
Komisioni i Pavarur i Mediave



15.05.2014
datë